

Ftesë

Prezantimi i studimit “Konsultimi Publik në Qeverisjen Qendrore”

Tryezë diskutimi, **datë 29 shtator, ora 10:00**

Konsultimi publik si një tregues i qeverisjes së mirë, hapësirës civile mundësuese dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, është një ndër kushtet e anëtarësimit evropian që lidhet me reformën në administratën publike. Megjithatë, pothuajse një dekadë nga miratimi i Ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, zbatimi i tij i vakët kërkon reflektim nga të gjithë aktorët.

Prej vitit 2021, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me mbështetjen e NED Washington DC, është angazhuar në zbatimin e projektit “Forcimi i transparencës dhe qeverisjes së mirë”. Kjo nismë, në fazën e saj të parë ofroi asistencës teknike dhe trajnime për institutionet e administratës qendrore, ndërsa në fazën e rradhës është investuar në hulumtimin dhe monitorimin e proceseve të konsultimit publik nga perspektiva e shoqërisë civile.

Në këtë kuadër, IDM ju fton në **tryezën e prezantimit të gjetjeve të studimit “Konsultimi Publik në Qeverisjen Qendrore”**, e cila do të mbahet **më datë 29 shtator ora 10:00** (*detajet e vendit konfirmohen në vijim me agjendën finale.*)

Studimi është kryer përgjatë 2022-2023 dhe ndërton mbi punën e mëparshme hulumtuese, analizat e politikave dhe sondazhet opinionit publik të kryera nga IDM. Ai ofron një vlerësim të gjendjes aktuale të konsultimit publik në nivelin e qeverisjes qendrore, përmes lenteve të parimeve të qeverisjes së mirë: efikasiteti, transparenca, aksesueshmëria, proaktiviteti dhe mosdiskriminimi. Në studim analizohet korniza ligjore, politike dhe mangësitë e evidentuara ndër vite, zbatimi i saj në çdo hallkë të procesit të konsultimit nga planifikimi dhe hartimi i draftit deri tek miratimi dhe raportimi, si dhe përfshirja dhe roli i aktorëve publik dhe jo publik.

Qëllimi parësor është që gjetjet t’i shërbejnë ndërgjegjësimit dhe advokimit për nevojën për ndryshime ligjore, të praktikës dhe të qasjes së aktorëve ndaj procesit, për të mundësuar përbushjen me efektivitet të funksionit për të cilin mbahen konsultimet publike – përfshirje dhe ndikim në vendimmarrje.

Duke vlerësuar kontributin tuaj në këtë diskutim si aktorë të shoqërisë civile, sektorit privat, grupeve të interesit, ju lutemi të njoftoni pjesëmarrjen **deri në datë 22 shtator**.

Mbetemi në pritje të konfirmimit tuaj,

Faleminderit për bashkëpunimin,

Sotiraq Hroni

Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Draft - Programi i takimit

Tryezë diskutimi, datë 29 shtator, ora 10:00

10:00	Regjistrimi i pjesëmarrësve / Kafe
10:15-10:30	Mirëseardhja Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv IDM
10:30-10:50	Prezantimi i gjetjeve të studimit “Konsultimi Publik në Qeverisjen Qendrore” Megi Reçi dhe Besjana Kuçi, Hulumtuese të IDM-së
10:50-11:30	Diskutime dhe kontribute nga pjesëmarrësit Gjergji Vurmo, Këshilltar i Lartë, IDM (moderator) Përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat, grupeve të interesit (tbc)
11:30-	Mbyllja e takimit / drekë